

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit NGLB "B." me seli në Prizren, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas revizionit të së paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.161/2015 datë 24.02.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 6.06. 2017, mori këtë,

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i së paditurës Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.161/2015 datë 24.02.2017 dhe të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike,C.nr.465/13 dt.7.05.2015, në pjesën që i referohet pagesës së shumës prej 44.503,97€.

II.PRANOHET revizioni i të paditurës përkitazi me lartësinë prej 3,5% të kamatës së gjykuar me aktgjykimet e sipërpërmendura, ashtu që në këtë pjesë të dy aktgjykimet NDRYSHOHEN dhe detyrohet e paditura që paditësit shumën e lartcekur t'ia paguajë me kamatë në lartësi të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga paraqitja e padisë e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.161/15 dt.24.02.2017 është refuzuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike, C.nr.465/13 dt.7.05.2015 me të cilin, është aprovuar

kërkesëpadia e paditësit dhe është detyruar e paditura që paditësit në emër të borxhit t'ia paguajë shumën prej 44.503,97 €, me kamatë ligjore prej 3.5% duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, brenda 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit dhe është detyruar që t'i paguajë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1820,00 €.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor e paditura ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e instancës më të ulët të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar.

Përgjigje në revizion ka paraqitur pala paditëse, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 lidhur me nenin 505 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i së paditurës është pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se midis palëve ndërgjyqësore është lidhur kontrata për shitblerje të mallrave. Kontratën për shitblerjen e mallrave dhe shërbimeve, e cila nuk është kontratë formale dhe për lidhjen e saj, ligji nuk parasheh detyrimisht formën me shkrim, e ka nënshkruar Agjencioni i Prokurimit Publik nr..., me datën 26.12.2008, në emër dhe llogari të së paditurës, me të cilën janë paraparë të drejtat dhe detyrimet e palëve. Me dispozitat e nenit 1.1 dhe 1.2 të Kontratës parashihet se lënda e kontratës duhet të jenë mallrat, dërgesa në Departamentin e regjistrimit të gjendjes civile në Ministrinë e Punëve të Brendshme përkatësisht se vendi i pranimit do të jetë Departamenti i regjistrimit të gjendjes civile në MPB dhe Kuvendet e Komunave të Kosovës (Furnizimi me regjistra dhe Certifikata të gjendjes civile). Me nenin 4, të kushteve të veçanta të kontratës, parashihet se komunikimet lidhur me realizimin e kontratës do të bëhen përmes përfaqësuesve të palëve të autorizuar nga kontraktuesit e që në emër të së paditurës ishte emri i Sh. L.-S., Zyrtare e mbështetjes së gjendjes civile në MPB, se çmimi i furnizimit është gjithsej 90.297,00€, ndërsa, paditësi kërkon pjesën e mbetur, të pa përmbushur të kontratës, në shumë prej 44.503,97€.

Duke u nisur nga gjendja e këtyllë faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se, paditësi me të paditurën ka qenë në marrëdhënie kontraktore detyimore, i ka dërguar mallin e porositur, se kontrata është përmbushur pjesërisht, por e njëjta ka mbetur e pa përmbushur për shumën prej 44.503,97€, prandaj, gjykata e shkallës së parë në bazë të dispozitave të nenit 262, nenit 100 të LMD-ës, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndaj, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Thëniet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi se janë të paqëndrueshme për faktin sepse janë dhënë arsyet e duhura për faktet relevante me rëndësi për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridiko-civile. Kështu, nëpërmjet zhvillimit dhe vlerësimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës në kuptim të nenit 8 të LPK-së, janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë faktet se midis palëve ndërgjyqësore ishte krijuar raporti kontraktues detyrimor i sipër theksuar, ndërsa, një pjesë e obligimit kontraktues nga e paditura ka mbetur e pa përmbushur. Kështu, në kontekst të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuese, duhet theksuar se me dispozitën e nenit 15.1 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve parashihet se "Në krijimin e kontratave të dyanshme, pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke" (Parimi i ekuivalencës së prestimeve), kurse, me dispozitën e nenit 17.1 të njëjtë Ligj, parashihet se "Pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit janë të detyruar të përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij". Ndërkohë që, edhe me dispozitën e nenit 100 të LMD-së parashihet se "Në rast kur kontrata është e lidhur sipas përmbajtjes së shtypur më parë ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese,

dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër”, etj. Prandaj, edhe pretendimet e revizionit se nga vlerësimi i gabuar i provave, gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron se nuk qëndron po ashtu as pretendimi i revizionit lidhur me mungesën e legjitimitetit real pasiv të së paditurës, kjo për faktin sepse, në bazë të shkresave të lëndës, kontratës së sipër cekur, faturave, fletë dërgesave etj., rezulton se e paditura është palë me legjitimitet real pasiv. Për palën përkatëse ndërgjyqësore thuhet se është me legjitimitet real, në qoftë se ajo është pjesëmarrëse në raportin materialo-juridik nga i cili ka lindur kontesti, siç është rasti konkret me, këtu, palën e paditur.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare lidhur me aplikimin e së drejtës materiale, gjeti se lartësia e kamatës për shumën e sipër cekur, nuk është e gjykuar në përputhje me dispozitën e nenit 277 të LMD-së, pasi që kamata në lartësi prej 3,5%, nuk është e thënë që të jetë e njëjtë në të gjitha bankat vendore, prandaj, aktgjykimet e të dy gjykatave përkitazi me kamatën, janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nga këtu, e konform dispozitës së nenit 224.1 të LPK-së, u vendos si në pjesën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 dhe 224.1 të LPK, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.E.nr.7/2017 datë 5.06.2017

Kryetari i kolegjit
Mr.sc.Muhamet Rexha